

LIGJ
Nr.9646, datë 27.11.2006

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR PASTRIMIN,
KËRKIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT DHE PËR
FINANCIMIN E TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, bërë në Varshavë më 16 maj 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5150, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E KËSHILLIT TË EUROPËS
PËR PASTRIMIN, DEPISTIMIN, SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E
PRODUKTEVE TË KRIMIT DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

Varshavë, 16.5.2005
Seria e traktateve europiane ETS nr.198

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente,
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të ngushtë midis anëtarëve të saj;

të bindur për nevojën për të ndjekur një politikë penale të përbashkët, me synim mbrojtjen e shoqërisë;

duke pasur parasysh se lufta kundër krimeve të rënda që është bërë gjithnjë e më shumë problem ndërkombëtar, kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efektive në shkallë ndërkombëtare;

duke besuar se njëra prej këtyre metodave konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit dhe instrumenteve për kryerjen e tyre;

duke pasur parasysh se me qëllim arritjen e këtij objekti, duhet të ngrihet një sistem funksional bashkëpunimi ndërkombëtar;

duke pasur parasysh Konventën e Këshillit të Europës mbi pastrimin, sekuestrimin, depistimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit (ETS nr.141 – që më poshtë do të quhet “Konventa e vitit 1990”);

duke sjellë ndër mend edhe Rezolutën 1373 (2001) mbi kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të shkaktuara nga aktet terroriste, të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara më 28 shtator 2001, dhe veçanërisht paragrafin 3.d të saj;

duke sjellë ndër mend Konventën ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1999 dhe veçanërisht nenet 2 dhe 4 të saj, që i detyrojnë Shtetet Palë ta cilësojnë financimin e terrorizmit si vepër penale;

të bindur për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së hapave të menjëhershëm për të ratifikuar dhe zbatuar plotësisht Konventën ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, të cituar më lart, janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

KREU I PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1 Përdorimi i termave

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;

b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;

c) “instrument” nënkupton të gjitha objektet e përdorura ose të destinuara për t’u përdorur në çfarëdolloj mënyre, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale;

d) “konfiskim” nënkupton një dënim ose masë të urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi, lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë;

e) “vepër penale kryesore” nënkupton çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një vepre penale sipas nenit 9 të kësaj Konvente.

f) “njësi e informacionit financiar” (që më poshtë do të quhet FIU) nënkupton një agjenci qendrore, kombëtare, përgjegjëse për marrjen (dhe sipas rastit, për kërkimin), analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente të raporteve të informacionit financiar:

i) në lidhje me fitimet e dyshimta dhe financimin e mundshëm të terrorizmit, ose

ii) që kërkohet nga legjislacioni apo rregulloret e brendshme, me qëllim luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

g) “ngrrirje” ose “bllokim” nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkatërrimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pasurisë apo realizimin e përkohshëm të izolimit ose kontrollit të pasurisë, mbi bazën e një vendimi të lëshuar nga një gjykatë ose një organ tjetër kompetent;

h) “financim i terrorizmit” nënkupton aktet e parashikuara në nenin 2 të Konventës ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, të cituar më sipër.

KREU II FINANCIMI I TERRORIZMIT

Neni 2 Zbatimi i Konventës për financimin e terrorizmit

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme, për t’i dhënë mundësi asaj të zbatojë dispozitat e krerëve III, IV dhe V të kësaj Konvente për financimin e terrorizmit.

2. Çdo Palë do të sigurojë, në veçanti, që ajo të jetë në gjendje të kërkojë, ndjekë, identifikojë, ngrijë, bllokojë dhe konfiskojë pasuri me origjinë të ligjshme dhe të paligjshme, të përdorur ose të destinuar për t’u përdorur me çdo mjet, pjesërisht ose tërësisht, për financimin e terrorizmit, ose fitimet e kësaj vepre penale dhe të sigurojë bashkëpunim për këtë qëllim në masën më të gjerë të mundshme.

KREU III MASAT QË DUHEN MARRË NË NIVEL KOMBËTAR

SEKSIONI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 3 **Masat e konfiskimit**

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i lejuar asaj konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u korrespondon këtyre produkteve.

2. Me kusht që paragrafi 1 i këtij neni të zbatohet në lidhje me pastrimin e parave dhe kategoritë e veprave penale të përfshira në shtojcën e kësaj Konvente, çdo Palë, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, mund të deklarojë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës se zbatohet paragrafi 1 i këtij neni:

a) në masën që vepra penale është e dënueshme me heqje lirie ose një urdhër ndalimi për një kohë maksimale mbi një vit. Megjithatë, çdo Palë mund të bëjë një deklaratë për këtë dispozitë në lidhje me konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga veprat penale me karakter tatimor, me qëllimin e vetëm për të qenë në gjendje të konfiskojnë produkte të tilla, përmes bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për rimarrjen e borxheve të shkaktuara nga mospagesa e taksave; dhe/ose

b) vetëm për një listë të specifikuar veprash penale.

3. Palët mund të parashikojnë konfiskimin e detyrueshëm në lidhje me veprat penale që i nënshtrohen regjimit të konfiskimit. Palët mund të përfshijnë në këtë dispozitë veçanërisht veprat penale të pastrimit të parave, trafikimit të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore dhe vepra të tjera të rënda penale.

4. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, për të kërkuar që në lidhje me një vepër të rëndë penale ose vepra penale sipas parashikimit në legjislacionin e brendshëm, autori i veprës penale të demonstrojë origjinën e produkteve të prezumuara ose të pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit në masën që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e legjislacionit të brendshëm.

Neni 4 **Masat hetuese dhe të përkohshme**

Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i mundësuar asaj identifikimin, ndjekjen, ngrirjen ose bllokimin e menjëhershëm të pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit në përputhje me nenin 3, me qëllim që të lehtësojë ekzekutimin e një konfiskimi të mëvonshëm.

Neni 5 **Ngrirja, bllokimi dhe konfiskimi**

Çdo Palë merr ato masa legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë edhe:

a) pasurinë në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet;

b) pasurinë e përfshirë nga burime të ligjshme, nëse fitimet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera;

c) të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga fitimet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet nga krimi ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet nga krimi, deri në vlerën e që vlerësohen fitimet e përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet.

Neni 6 **Menaxhimi i pasurisë së ngrirë ose të bllokuar**

Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të siguruar menaxhimin e duhur të pasurisë së ngrirë ose të bllokuar, në përputhje me nenet 4 dhe 5 të kësaj Konvente.

Neni 7

Kompetencat dhe teknikat e hetimit

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'u dhënë kompetencë gjykatave ose organeve të tjera kompetente për të urdhëruar që të jepen ose bllokohen regjistrat bankarë, financiarë ose tregtarë, me qëllim që të kryhen veprimet e përmendura në nenet 3, 4 dhe 5. Një Palë nuk mund të zgjedhë të mos veprojë në përputhje me dispozitat e këtij neni, për shkak të sekretit bankar.

2. Pa cenuar paragrafin 1, çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i mundësuar asaj:

a) të përcaktojë nëse një person fizik ose juridik është mbajtës ose pronar përfitues i një ose më shumë llogarive të çdo natyre, në çdo bankë që ndodhet në territorin e saj dhe nëse është kështu, të marrë të gjitha të dhënat e llogarive të identifikuara;

b) të marrë të dhënat e llogarive të caktuara bankare dhe të operacioneve bankare që janë kryer gjatë një afati të caktuar nëpërmjet një ose disa llogarive të caktuara, duke përfshirë të dhënat e çdo llogarie dërguese ose marrëse;

c) të vëzhgojnë gjatë një periudhe të caktuar, operacionet bankare që kryhen nëpërmjet një ose disa llogarive të identifikuara; dhe

d) të sigurojnë që bankat të mos i bëjnë të ditur klientit përkatës të bankës ose palëve të treta që është kërkuar ose marrë informacion në përputhje me nënparagrafët a, b ose c apo që është kryer një hetim.

Palët do të konsiderojnë shtrirjen e kësaj dispozite edhe për llogaritë e mbajtura në institucionet financiare jobankare.

3. Çdo Palë do të shqyrtojë miratimin e atyre masave legislative dhe masave të tjera të nevojshme, për t'i dhënë mundësi asaj të përdorë teknika të veçanta të hetimit, duke lehtësuar identifikimin dhe gjurmimin e produkteve dhe mbledhjen e provave për këtë qëllim, si vëzhgimin, përgjimin e telekomunikimit, aksesin në sistemet kompjuterike dhe urdhërimin për të dhënë dokumente të caktuara.

Neni 8

Zgjidhjet ligjore

Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, me qëllim që personat e cenuar nga masat e parashikuara nga nenet 3, 4 dhe 5, si dhe dispozitat e tjera në këtë seksion, të kenë të drejtën për zgjidhje ligjore për të mbrojtuar të drejtat e tyre.

Neni 9

Veprat penale të pastrimit të parave

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, për t'i atribuar aktit karakterin e veprës penale, në përputhje me të drejtën e brendshme, kur akti është kryer me qëllimin për:

a) kthimin ose transferimin e pasurive, me dijeninë që kjo pasuri përbëhet nga të ardhura, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person të përfshirë në kryerjen e veprës penale kryesore, për t'i shpëtuar pasojave ligjore të akteve të tij;

b) fshehjen ose maskimin e natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave në lidhje me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte;

dhe, objekt i parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelore të sistemit juridik të vet;

c) përvetësimin, mbajtjen ose përdorimin e pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor,

është në dijeni, në kohën kur i merr, se ato përbëjnë të ardhura;

d) pjesëmarrjen në mënyrë të organizuar ose në bashkëpunim për kryerjen, tentativën për të kryer dhe ndihmën ose këshillave për kryerjen e një prej veprave penale të treguara në përputhje me këtë nen.

2. Për qëllime të realizimit ose zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni:

a) nuk do të merret parasysh fakti nëse vepra penale kryesore është ose jo kompetencë e juridiksionit penal të Palës;

b) mund të parashikohet se veprat penale të parashtruara nga ky paragraf, nuk zbatohen ndaj autorëve të veprës penale;

c) pasja dijeni, qëllim ose motivim, të nevojshëm si elemente të veprës penale të parashtruar nga ai paragraf, mund të nxirren nga rrethana faktike objektive.

3. Çdo Palë mund të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të klasifikuar si vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, të gjitha ose disa prej akteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, në njërin ose në të dy rastet e mëposhtme, kur autori:

a) dyshonte se pasuria ishte produkt i krimit;

b) duhet të kishte supozuar se pasuria ishte produkt i krimit.

4. Me kusht që paragrafi 1 i këtij neni të zbatohet për kategoritë e veprave penale në shtojcën e kësaj Konvente, çdo Palë e Komunitetit European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të deklarojë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, se zbatohet paragrafi 1 i këtij neni:

a) në masën që vepra penale kryesore është e dënueshme me heqje lirie ose një urdhër ndalimi për një periudhë maksimale mbi një vit ose për ato Palë që kanë një kufi minimal dënimi për veprat penale në sistemin e tyre ligjor në masën që vepra penale kryesore është e dënueshme me heqje lirie ose një urdhër ndalimi për një kohë minimale mbi gjashtë muaj; dhe/ose

b) vetëm për një listë të specifikuar veprash penale dhe/ose

c) për një kategori veprash penale të rënda, të specifikuara në legjislacionin e brendshëm.

5. Çdo Palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash.

6. Çdo Palë do të garantojë që një dënim për pastrim parash në bazë të këtij neni është i mundshëm, nëse vërtetohet që një pasuri, objekt i paragrafit 1.a ose b i këtij neni, e ka origjinën nga një vepër penale kryesore, pa qenë e nevojshme të caktohet saktësisht se cila vepër penale.

7. Çdo Palë do të garantojë që veprat penale kryesore të pastrimit të parave të shtrihen edhe në sjelljet që kryhen në një shtet tjetër, kur në atë shtet përbëjnë vepra penale dhe që do të përbënin vepra penale kryesore nëse do të ishin kryer brenda vendit. Çdo Palë mund të parashikojë që i vetmi parakusht të jetë që sjellja të përbënte vepër penale kryesore, nëse do të kishte ndodhur brenda vendit.

Neni 10

Përgjegjësia e personave juridikë

1. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që një person juridik mund të konsiderohet përgjegjës për veprën penale të pastrimit të parave të përcaktuar sipas kësaj Konvente, të kryer për qëllim përfitimi nga një person fizik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik që ka një pozicion drejtues brenda këtij personi juridik, bazuar në:

a) një prokurë nga personi juridik;

b) një autoritet që merr vendime në emër të personit juridik; dhe

c) një autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve që janë parashikuar në paragrafin 1, çdo Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik të mund të konsiderohet përgjegjës, kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprës penale të përcaktuar sipas paragrafit 1, për përfitim të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.

3. Kjo përgjegjësi e përcaktuar në këtë nen nuk do të përjashtojë procedimet penale kundër personave fizikë që kanë kryer, nxitur apo ndihmuar në kryerjen e veprave penale referuar në paragrafin 1.

4. Çdo Palë do të sigurojë që personat juridikë që përgjigjen në përputhje me këtë do të jenë

objekt i sanksioneve ligjore efektive, proporcionale, penale ose jopenale, duke përfshirë dhe sanksionet financiare, me qëllim dhënien fund të veprimtarisë antiligjore.

Neni 11

Vendimet e mëparshme

Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të parashikuar mundësinë e marrjes parasysh, në kohën e caktimit të masës së dënimit, të vendimeve të formës së prerë kundër një personi fizik ose juridik, të marra në një Palë tjetër në lidhje me veprat penale të parashikuara në këtë Konventë.

SEKSIONI 2

NJËSIA E INFORMACIONIT FINANCIAR (FIU) DHE PARANDALIMI

Neni 12

Njësia e informacionit financiar (FIU)

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme, për krijimin e një FIU sipas parashikimit në këtë Konventë.

2. Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme, për të siguruar që FIU i saj të ketë të drejtë, drejtpërdrejt ose jo mbi bazë kohore, të marrë informacione financiare, administrative dhe për ekzekutimin ligjor që i nevojitet atij për të kryer si duhet funksionet e tij, duke përfshirë analizën e raporteve të transaksioneve të dyshimta.

Neni 13

Masat për parandalimin e pastrimit të parave

1. Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të vendosur një regjim të plotë të brendshëm rregullues dhe mbikëqyrës për të parandaluar pastrimin e parave dhe merr parasysh si duhet standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke përfshirë veçanërisht rekomandimet e miratuara nga Task Force për Veprimin Financiar mbi Pastrimin e Parave (FATF).

2. Në lidhje me këtë, çdo Palë do të marrë veçanërisht ato masa legjislative dhe masa të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme:

a) për t'u kërkuar personave juridikë dhe fizikë që përfshihen në aktivitete, të cilat janë veçanërisht të mundshme për t'u përdorur për qëllime të pastrimit të parave dhe për aq sa kanë të bëjnë me këto aktivitete:

i) të identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e klientëve të tyre dhe sipas rastit, pronarët përfundimtarë përfitues dhe të tregojnë vazhdimisht kujdesin e duhur për marrëdhëniet e biznesit, duke marrë parasysh një qëndrim të bazuar mbi rrezikun;

ii) të raportojnë dyshimet për pastrimin e parave që i nënshtrohet garancisë;

iii) të marrin masa mbështetëse, si regjistrimi i identifikimit të klientëve dhe transaksioneve, trajnimi i personelit dhe caktimi i politikave dhe procedurave të brendshme dhe sipas rastit, të përshtatura me madhësinë dhe natyrën e biznesit;

b) për të ndaluar, sipas rastit, që personat e përmendur në nënparagrafin "a" të tregojnë faktin se është transmetuar një raport për një transaksion të dyshimtë ose një informacion përkatës apo që është kryer ose po kryhet një hetim në lidhje me pastrimin e parave;

c) për të siguruar që personat e përmendur në nënparagrafin "a", u nënshtrohen sistemeve efektive për monitorimin, dhe sipas rastit edhe vëzhgimin, me qëllim që të sigurohet respektimi prej tyre i kërkesave për të luftuar pastrimin e parave, sipas rastit të bazuar mbi rrezikun.

3. Në lidhje me këtë, çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të zbuluar transportin e konsiderueshëm fizik të parave përtej kufirit dhe instrumente të përshtatshme të negociueshme për prurësin.

Neni 14

Shtyrja e transaksioneve të brendshme të dyshimta

Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të lejuar veprimin e menjëhershëm të ndërmarrë nga FIU ose sipas rastit, nga çdo organ apo autoritet tjetër kompetent, nëse ka dyshim që një transaksion lidhet me pastrim parash, për të pezulluar ose mos dhënë pëlqimin për transaksionin që po kryhet, me qëllim që të analizojë transaksionin dhe konfirmojë dyshimin. Çdo Palë mund t'a kufizojë një masë të tillë për çështjet për të cilat është dhënë një raport për transaksione të dyshimta. Kohëzgjatja maksimale e çdo pezullimi ose mosdhënies së pëlqimit për një transaksion i nënshtrohet dispozitave në ligjin e brendshëm.

KREU IV BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

SEKSIONI 1 PARIMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Neni 15

Parimet e përgjithshme dhe masat për bashkëpunimin ndërkombëtar

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën sa më shumë që të jetë e mundur për qëllime të hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit.

2. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, për t'i lejuar asaj, me kushtet e parashikuara në këtë kapitull, t'u përgjigjet kërkesave:

a) për konfiskimin e pasurive të caktuara që përbëjnë produkte ose instrumente, si dhe për konfiskimin e produkteve që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash, e cila i korrespondon vlerës së produktit;

b) për ndihmën e ndërsjellë për qëllime të hetimit dhe masave të përkohshme, të cilat synojnë njërën nga format e konfiskimit të përmendura në pikën a më sipër.

3. Asistenca në hetim dhe masat e përkohshme të parashikuara në paragrafin 2.b zbatohen sipas parashikimit dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës pritëse. Nëse kërkesa në lidhje me një nga këto masa ka të bëjë me formalitete ose procedura që mund të jenë të mundshme vetëm në bazë të legjislacionit të Palës kërkuese, edhe nëse janë të panjohura për Palën e kërkuar, kjo e fundit i plotëson këto kërkesa deri në atë masë që veprimi i kërkuar të mos jetë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës.

4. Çdo Palë do të marrë ato masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, për të garantuar që kërkesat të cilat vijnë nga Palë të tjera për identifikimin, ndjekjen, ngrirjen ose bllokimin e produkteve dhe mjeteve, të kenë të njëjtin prioritet si ato të bëra në kuadrin e procedurave të brendshme.

SEKSIONI 2 ASISTENCA NË HETIM

Neni 16

Detyrimi për të asistuar

Sipas kërkesës, Palët do t'i japin njëra-tjetrës në shkallën më të lartë të mundshme, asistencë për identifikimin dhe ndjekjen e mjeteve, produkteve dhe pasurive të tjera që i nënshtrohen konfiskimit. Kjo asistencë do të përfshijë çdo masë që jep dhe garanton prova në lidhje me ekzistencën, vendndodhjen ose lëvizjen, natyrën, statusin ligjor apo vlerën e pasurisë së sipërpërmendur.

Neni 17

Kërkesat për informacion mbi llogaritë bankare

1. Çdo Palë, në kushtet e parashikuara në këtë nen, do të marrë ato masa që mund të rezultojnë të nevojshme për të përcaktuar, në përgjigje të një kërkesë dërguar nga një Palë tjetër, nëse një person fizik ose juridik që i nënshtrohet procedimit penal, mban ose kontrollon një ose më shumë llogari të çfarëdolloj natyre, në çdo bankë që ndodhet në territorin e saj dhe në një rast të tillë, do të japë hollësitë e llogarive të identifikuara.

2. Detyrimi i parashikuar në këtë nen zbatohet vetëm në masën që informacioni është në zotërimin e bankës që ka llogarinë.

3. Përveç kërkesave të nenit 37, Pala kërkuuese, në kërkesë:

a) shpjegon se pse ajo mendon që informacioni i kërkuar mund të jetë me vlerë thelbësore për qëllimet e procedimit penal të veprës;

b) shpjegon se ku e mbështet prezumimin që bankat në Palën e kërkuar kanë llogari dhe përcakton në masën më të gjerë të mundshme, cilat banka dhe /ose llogari mund të përfshihen; dhe

c) përfshin çdo informacion shtesë të mundshëm që mund të lehtësojë ekzekutimin e kërkesës.

4. Pala e kërkuar mund ta kushtëzojë ekzekutimin e kësaj kërkesë me të njëjtat kushte që ajo cakton në lidhje me kërkesat për kërkimin dhe bllokimin.

5. Çdo shtet ose Komuniteti European, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë që ky nen zbatohet vetëm për kategoritë e veprave penale të përcaktuara në listën që gjendet në shtojcën e kësaj Konvente.

6. Palët mund ta shtrijnë këtë dispozitë në llogaritë që mbahen tek institucionet financiare jobankare. Kjo shtrirje mund t'i nënshtrohet parimit të reciprocitetit.

Neni 18

Kërkesat për informacion mbi transaksionet bankare

1. Me kërkesë nga një Palë tjetër, Pala e kërkuar jep hollësitë e llogarive bankare të caktuara dhe të operacioneve bankare që janë kryer gjatë një afati të caktuar nëpërmjet një ose disa llogarive të caktuara në kërkesë, duke përfshirë hollësitë e çdo llogarie dërguese ose marrëse.

2. Detyrimi i parashikuar në këtë nen zbatohet vetëm në masën që informacioni është në zotërimin e bankës që mban llogarinë.

3. Përveç kërkesave të nenit 37, Pala kërkuuese në kërkesën e saj tregon pse ajo e konsideron informacionin e kërkuar, të përshtatshëm për qëllimin e procedimit penal të veprës penale.

4. Pala e kërkuar mund ta kushtëzojë ekzekutimin e një kërkesë të tillë me të njëjtat kushte që ajo zbaton në lidhje me kërkesat për kërkimin dhe bllokimin.

5. Palët mund ta shtrijnë këtë dispozitë në llogaritë që mbahen në institucionet jobankare. Kjo shtrirje mund t'i nënshtrohet parimit të reciprocitetit.

Neni 19

Kërkesat për monitorimin e transaksioneve bankare

1. Çdo Palë do të garantojë që me kërkesën e një Pale tjetër, të jetë në gjendje të monitorojë gjatë një periudhe të caktuar operacionet bankare që kryhen nëpërmjet një ose disa llogarive të caktuara në kërkesë dhe t'ia komunikojë rezultatet e saj Palës kërkuuese.

2. Përveç kërkesave të nenit 37, Pala kërkuuese tregon në kërkesën e saj se e konsideron informacionin e kërkuar të përshtatshëm për qëllimin e procedimit penal të veprës penale.

3. Vendimi për monitorim merret për çdo rast të veçantë nga organet kompetente të Palës pritëse, duke respektuar përkatësisht legjislacionin e brendshëm të kësaj Pale.

4. Detajet praktike në lidhje me monitorimin do të caktohen me marrëveshje ndërmjet organeve kompetente të Palës kërkuuese dhe asaj të kërkuar.

5. Palët mund ta shtrijnë këtë dispozitë në llogaritë që mbahen nga institucionet financiare jobankare.

Neni 20

Informacionet spontane

Pa cenuar hetimet dhe procedimet penale të tyre, autoritetet kompetente të një Pale munden që, pa ndonjë kërkesë paraprake, t'i transmetojnë informacion për instrumentet dhe produktet e krimit një Pale tjetër, i cili mund të jetë përfutur në kuadrin e hetimit të bërë nga kjo Palë, dhe kur çmohet se vënia në dispozicion e këtij informacioni mund të ndihmojë Palën që merr informacionin për fillimin ose mbarëvajtjen e një hetimi ose të një procedimi penal ose kur këto informacione mund të çojnë në bërjen e një kërkesë nga kjo Palë mbi bazën e dispozitave të këtij kreu.

SEKSIONI 3 MASA TË PËRKOHSHME

Neni 21

Detyrimi për urdhërimin e marrjes së masave të përkohshme

1. Me kërkesë të një Pale tjetër që ka filluar një procedim ose një veprim për konfiskim, Pala në fjalë merr masat e përkohshme të nevojshme, të tilla si ngrirja ose sekuestrimi, për të parandaluar çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me çdo pasuri që më pas mund të bëhet objekt i një kërkesë konfiskimi ose që mund t'i japë rrugë plotësimi të kërkesës.

2. Pala që ka marrë një kërkesë konfiskimi në përputhje me nenin 23, merr masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, kur për këtë është bërë kërkesa lidhur me çdo pasuri që është objekt i kërkesës ose që mund t'i japë rrugë plotësimi të kërkesës.

Neni 22

Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Pas ekzekutimit të masave të përkohshme të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 21, Pala kërkuuese do t'i sigurojë Palës së kërkuar, në mënyrë spontane dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, të gjithë informacionin që mund të analizojë apo modifikojë nivelin e këtyre masave. Pala kërkuuese gjithashtu do të sigurojë pa vonesë të gjithë informacionin plotësues të kërkuar nga Pala e kërkuar dhe që është i nevojshëm për zbatimin dhe ndjekjen e masave të përkohshme.

2. Para heqjes së çdo mase të përkohshme që është marrë në përputhje me këtë nen, Pala e kërkuar, brenda mundësive, i jep Palës kërkuuese mundësinë të paraqesë arsyet në favor të mbajtjes së metejshme të masës.

SEKSIONI 4 KONFISKIMI

Neni 23

Detyrimi për konfiskim

1. Pala që ka marrë nga një Palë tjetër një kërkesë konfiskimi lidhur me instrumentet ose produktet që ndodhen në territorin e saj:

a) duhet të ekzekutojë vendimin e konfiskimit që del nga një gjykatë e Palës kërkuuese lidhur me këto instrumente ose produkte; ose

b) duhet t'ia paraqesë këtë kërkesë autoriteteve të veta kompetente për të marrë një vendim konfiskimi dhe kur ky është dhënë, atëherë të ekzekutohet.

2. Për qëllime të zbatimit të paragrafit 1.b të këtij neni, çdo Palë ka kompetencë, sa herë që lind nevoja, të fillojë një procedim konfiskimi në bazë të së drejtës së vet të brendshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen gjithashtu për konfiskimin lidhur me detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, nëse pasuritë mbi të cilat mund të bëhet konfiskim ndodhen në territorin e Palës së kërkuar. Në raste të tilla, duke proceduar me konfiskimin në përputhje me paragrafin 1, Pala e kërkuar, kur nuk është bërë pagesa, do të ngrejë pretendimin mbi çdo pasuri, që është vënë në dispozicion për këtë qëllim.

4. Kur kërkesa për konfiskim synon një objekt të përcaktuar pasurie, Palët mund të merren

vesh që Pala e kërkuar të mund të procedojë me konfiskimin në formën e një detyrimi, për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së pasurisë.

5. Palët bashkëpunojnë në masën më të gjerë të mundshme, në bazë të legjislacionit të tyre të brendshëm, me ato Palë që kërkojnë ekzekutimin e masave ekuivalente me konfiskimin, që çojnë në shpronësim, që nuk janë sanksione penale, nëse këto masa janë vendosur nga një organ gjyqësor i Palës kërkuese në lidhje me një vepër penale, me kusht që të jetë vërtetuar se pasuria përbëhet nga fitime ose pasuri tjetër sipas kuptimit të nenit 5 të kësaj Konvente.

Neni 24

Ekzekutimi i konfiskimit

1. Procedurat për marrjen dhe ekzekutimin e konfiskimit në bazë të nenit 23, rregullohen sipas ligjit të Palës së kërkuar.

2. Pala e kërkuar do të bjerë dakord me konstatimin e fakteve në masën që këto janë paraqitur në një dënim ose vendim gjyqësor të Palës kërkuese ose në masën që mbështeten në mënyrë të tërthortë në to.

3. Çdo Shtet Palë ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, se paragrafi 2 i këtij neni zbatohet vetëm me rezervën e parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelore të sitemit të vet juridik.

4. Kur konfiskimi konsiston në detyrimin për të paguar një shumë parash, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar e konverton shumën në monedhën e atij vendi sipas kursit të këmbimit në fuqi, në kohën kur merret vendimi i ekzekutimit të konfiskimit.

5. Në rastet e parashikuara në nenin 23 paragrafi 1.a, vetëm Pala kërkuese ka të drejtë të vendosë lidhur me çdo kërkesë rishikimi të vendimit të konfiskimit.

Neni 25

Pasuritë e konfiskuara

1. Pasuritë e konfiskuara prej një Pale në përputhje me nenet 23 dhe 24 të kësaj Konvente, do të dispononte prej asaj Pale, në përputhje me të drejtën e saj të brendshme, si dhe procedurat përkatëse administrative.

2. Nëse veprohet me kërkesë të një Pale tjetër në përputhje me nenet 23 dhe 24 të kësaj Konvente, në masën e lejuar nga ligji i brendshëm dhe nëse kjo kërkohej, Palët i japin prioritet kthimit të pasurisë së konfiskuar Palës kërkuese, në mënyrë që kjo të kompensojë viktimat e krimit ose t'ua kthejë këtë pasuri pronarëve të ligjshëm.

3. Nëse veprohet me kërkesë të një Pale tjetër në përputhje me nenet 23 dhe 24 të kësaj Konvente, një Palë mund të konsiderojë në veçanti lidhjen e marrëveshjeve ose krijimin e faciliteteve për ndarjen me Palët e tjera të kësaj pasurie, në mënyrë periodike ose rast pas rasti, në përputhje me të drejtën e saj të brendshme, si dhe procedurat përkatëse administrative.

Neni 26

E drejta e ekzekutimit dhe shuma maksimale e konfiskimit

1. Kërkesa për konfiskim bërë në përputhje me nenet 23 dhe 24 të kësaj Konvente, nuk cenon të drejtën e Palës kërkuese të ekzekutojë vetë kërkesën për konfiskim.

2. Asgjë nuk do të interpretohet në këtë Konventë sikur kjo të lejojë që vlera totale e pasurive të konfiskuara të jetë më e madhe se shuma e specifikuar me vendimin e konfiskimit. Kur një Palë konstaton se kjo mund të ndodhë, Palët përkatëse bëjnë konsultime për të shmangur një rrjedhojë të tillë.

Neni 27

Burgimi si masë shtrënguese

Pala e kërkuar nuk mund të vendosë burgimin si masë shtrënguese dhe as të marrë ndonjë

masë tjetër kufizuese të lirisë, në zbatim të një kërkesë të paraqitur në bazë të nenit 23, kur Pala kërkuese nuk e ka specifikuar këtë gjë në kërkesën përkatëse.

SEKSIONI 5 REFUZIMI DHE SHTYRJA E BASHKËPUNIMIT

Neni 28

Motivet e refuzimit

1. Bashkëpunimi në bazë të këtij kreu mund të refuzohet në rast se:

a) masa e kërkuar është në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të Palës së kërkuar; ose

b) ekzekutimi i kërkesës rrezikon të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore të Palës së kërkuar; ose

c) pala e kërkuar çmon se rëndësia e çështjes me të cilën ka të bëjë kërkesa nuk justifikon marrjen e masës së kërkuar; ose

d) vepra penale me të cilën lidhet kërkesa, është veprë penale fiskale, me përjashtim të financimit të terrorizmit; ose

e) vepra penale me të cilën lidhet kërkesa, është veprë penale politike, me përjashtim të financimit të terrorizmit; ose

f) pala e kërkuar konsideron se masa e kërkuar do të binte në kundërshtim me parimin “*ne bis in idem*”; ose

g) vepra penale me të cilën lidhet kërkesa nuk është veprë penale në vështirësi të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar, nëse do të ishte kryer në territorin nën juridiksionin e saj. Megjithatë, ky motiv refuzimi zbatohet për bashkëpunimin e parashikuar nga seksioni 2 vetëm në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar sjell marrjen e masave shtrënguese.

2. Bashkëpunimi i parashikuar në seksionin 2, në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar sjell marrjen e masa shtrënguese dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu, mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara nuk mund të merren në bazë të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar, për qëllime hetimesh ose procedimesh, nëse kjo Palë do të kishte një çështje të brendshme të ngjashme. Aty ku për bashkëpunimin sipas këtij kreu kërkohet kriminalizimi i dyfishtë, kërkesa do të konsiderohet e kënaqshme pavarësisht nëse të dyja Palët e kategorizojnë në të njëjtën kategori ose e cilësojnë njëloj këtë veprë, me kusht që të dyja Palët të kriminalizojnë sjelljen që është në thelb të veprës penale.

3. Kur e kërkon legjislacioni i Palës së kërkuar, bashkëpunimi i parashikuar në seksionin 2, në masën që ndihma e kërkuar përfshin marrjen e masave shtrënguese dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu, mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara ose të gjitha masat e tjera që kanë efekte analoge nuk lejohen nga legjislacioni i Palës kërkuese ose për sa i përket autoriteteve kompetente të Palës kërkuese, kur kërkesa nuk është autorizuar as nga gjyqtari, as nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe prokurorin publik, autoritete që veprojnë në fushën e veprave penale.

4. Bashkëpunimi i parashikuar në seksionin 4 të këtij kreu mund të refuzohet gjithashtu kur:

a) legjislacioni i Palës së kërkuar nuk parashikon konfiskimin për tipin e veprës penale, me të cilën ka të bëjë kërkesa; ose

b) pa cenuar detyrimin sipas nenit 23, paragrafi 3, ai do të binte ndesh me parimet e së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar, për sa i përket mundësive të konfiskimit në lidhje me marrëdhënien e një veprë penale dhe:

i) avantazhit ekonomik që mund të konsiderohet si produkt i tij; ose

ii) pasurive që mund të konsiderohen si instrumente të tij; ose

c) në bazë të legjislacionit të palës së kërkuar, vendimi për konfiskim nuk mund të jepet ose ekzekutohet për shkak të mungesës së kohës; ose

d) pa cenuar detyrimin sipas nenit 23, paragrafi 5, kërkesa nuk ka të bëjë me një dënim të mëparshëm, as me një vendim me karakter gjyqësor, as me një deklaratë që figuron në një vendim të tillë, deklaratë sipas së cilës janë kryer një ose disa vepra penale dhe që ka qenë në themel të vendimit ose të kërkesës për konfiskim; ose

e) konfiskimi nuk është i ekzekutueshëm në Palën kërkuese ose është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme të apelimit; ose

f) kërkesa lidhet me një urdhër konfiskimi të dhënë në mungesë të personit ndaj të cilit është dhënë vendimi dhe kur sipas Palës së kërkuar, procedimi i filluar nga Pala kërkuese dhe që ka çuar në këtë vendim, nuk ka përmbushur të drejtat minimale të mbrojtjes që i njihen çdo personi të akuzuar për një vepër penale.

5. Në vështrim të paragrafit 4.f të këtij neni, vendimi nuk çmohet të jetë dhënë në mungesë të të pandehurit:

a) kur ai është konfirmuar ose dhënë pas kundërshtimit nga personi i interesuar; ose

b) kur ai është dhënë në apel, me kusht që apeli të jetë kërkuar nga personi i interesuar.

6. Në shqyrtimet që bëhen për qëllime të paragrafit 4.f të këtij neni, nëse janë respektuar të drejtat minimale të mbrojtjes, Pala e kërkuar do të ketë parasysh faktin që personi i interesuar ka kërkuar qëllimisht t'i fshihet drejtësisë ose që ky person, pasi ka pasur mundësinë të paraqesë një ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, ka preferuar të mos paraqesë një ankim të tillë. E njëjta gjë do të zbatohet kur personi i interesuar, pasi është thirrur rregullisht për t'u paraqitur në gjyq, ka preferuar të mos paraqitet ose të mos kërkojë shtyrjen e shqyrtimit të çështjes.

7. Pala nuk mund të pretendojë të ngrejë çështjen e sekretit bankar për të justifikuar refuzimin e saj për çfarëdo bashkëpunimi të parashikuar në këtë kapitull. Kur e drejta e vet e brendshme e kërkon, Pala mund të kërkojë që kërkesa për bashkëpunim, e cila do të sjellë heqjen e sekretit bankar, të lëshohet nga gjyqtari ose nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë edhe prokurorin publik apo autoritete të tjera që veprojnë në fushën e veprave penale.

8. Pa cenuar motivin e refuzimit të parashikuar në paragrafin 1.a të këtij neni:

a) fakti që personi që është bërë objekt i një hetimi të ndërmarrë ose i një urdhri për konfiskim, të marrë nga autoritetet e Palës kërkuese, është një person juridik, nuk mund të ngrihet nga Pala e kërkuar si pengesë për ofrimin e çfarëdolloj bashkëpunimi në bazë të këtij kreu;

b) fakti që personi fizik ndaj të cilit është dhënë një urdhër për konfiskimin e produkteve, më pas ka vdekur, si dhe fakti që personi juridik ndaj të cilit është dhënë një urdhër për konfiskimin e produkteve, më pas është shuar, nuk mund të paraqiten si pengesë për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë të parashikuar nga neni 23, paragrafi 1.a

c) fakti që personi që është bërë objekt i një hetimi të ndërmarrë ose i një urdhri për konfiskim të marrë nga autoritetet e Palës kërkuese, është përmendur në kërkesë njëkohësisht si autor i një veprë të caktuar penale dhe si autor i veprës penale të pastrimit të parave, nuk mund të ngrihet nga Pala e kërkuar si pengesë për ofrimin e çfarëdo bashkëpunimi në bazë të këtij kreu.

Neni 29

Shtyrja

Pala e kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e masave të parashikuara në një kërkesë, kur ato rrezikojnë të cenojnë hetimet ose procedimet e ndërmarra nga autoritetet e veta.

Neni 30

Pranimi i pjesshëm ose me kusht i kërkesës

Para se të refuzojë ose shtyjë për më vonë bashkëpunimin në bazë të këtij kreu, Pala e kërkuar, kur e kërkon rasti, shqyrton pas konsultimeve me Palën kërkuese, nëse mund t'i japë të drejtë asaj pjesërisht ose me kushtet që Pala e kërkuar çmon të nevojshme.

SEKSIONI 6

NJOFTIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË TË TRETËVE

Neni 31

Njoftimi i dokumenteve

1. Palët do t'i japin njëra-tjetrës, sa më shumë të jetë e mundur, ndihmën e ndërsjellë për njoftimin e akteve gjyqësore personave përkatës, lidhur me masat e përkohshme dhe konfiskimin.

2. Asgjë në këtë nen nuk mund të bëhet pengesë:

a) për mundësinë e dërgimit të akteve gjyqësore në rrugë postare drejtpërsëdrejti personave që ndodhen jashtë shtetit;

b) për mundësinë e nëpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave kompetentë të Palës kërkuese për të bërë veprime lidhur me njoftimin ose dorëzimin e akteve gjyqësore drejtpërsëdrejti, me anë të autoriteteve konsullore të kësaj Pale ose me anë të nëpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave të tjerë kompetentë të Palës së kërkuar,

përveçse kur Pala e kërkuar i ka bërë një deklaratë për të kundërtën Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Gjatë njoftimit të akteve gjyqësore jashtë shtetit personave përkatës që kanë të bëjnë me masa të përkohshme ose vendime konfiskimi të urdhëruara në Palën kërkuese, kjo Palë i informon këta persona për të drejtën e garantuar nga legjislacioni për t'iu vënë në dispozicion zgjidhje ligjore.

Neni 32

Njohja e vendimeve të huaja

1. Kur trajtohet një kërkesë për bashkëpunim sipas seksioneve 3 dhe 4, Pala e kërkuar njeh çdo vendim gjyqësor të dhënë në Palën kërkuese përsa i përket të drejtave që kërkohen nga të tretët.

2. Njohja mund të refuzohet:

a) kur të tretët nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të kërkuar të drejtat e tyre; ose

b) kur vendimi është i papajtueshëm me një vendim të mëparshëm të dhënë në Palën kërkuese për të njëjtën çështje; ose

c) kur ai është i papajtueshëm me rendin publik të Palës së kërkuar; ose

d) kur vendimi është dhënë në kundërshtim me dispozitat në fushën e kompetencës ekskluzive të parashikuar nga e drejta e Palës së kërkuar.

SEKSIONI 7

PROCEDURA DHE RREGULLA TË TJERA TË PËRGJITHSHME

Neni 33

Autoriteti qendror

1. Palët do të caktojnë një autoritet qendror ose sipas nevojës, disa autoritete të ngarkuara me dërgimin e kërkesave të formuluar në bazë të këtij kreu, për t'iu përgjigjur, për t'i ekzekutuar ose për t'ua transmetuar autoriteteve që kanë kompetencë për ekzekutim.

2. Çdo Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, emërtimin dhe adresën e autoriteteve kompetente të caktuara për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 34

Komunikimi i drejtpërdrejtë

1. Autoritetet qendrore komunikojnë drejtpërsëdrejti midis tyre.

2. Në raste urgjente, autoritetet gjyqësore, duke përfshirë prokurorin publik të Palës kërkuese, mund t'u dërgojnë drejtpërsëdrejti kërkesat dhe komunikimet e parashikuara nga ky kapitull autoriteteve homologe të Palës së kërkuar. Në raste të tilla, një kopje duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit qendror të Palës së kërkuar, me ndërmjetësinë e autoritetit qendror të Palës kërkuese.

3. Çdo kërkesë ose komunikim i formuluar në zbatim të paragrafëve 1 e 2 të këtij neni, mund të paraqitet me ndërmjetësinë e Organizatës së Policisë Kriminale Ndërkombëtare (INTERPOL).

4. Kur një kërkesë paraqitet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni dhe kur autoriteti nuk është kompetent për t'i dhënë rrugë, ai ia transmeton atë autoritetit kompetent të vendit të vet dhe informon për këtë drejtpërsëdrejti Palën kërkuese.

5. Kërkesat ose komunikimet e paraqitura në bazë të seksionit 2 të këtij kreu, të cilat nuk sjellin marrjen e masave shtrënguese, mund t'i transmetohen drejtpërsëdrejti autoritetit kompetent të Palës së kërkuar nga autoriteti kompetent i Palës kërkuese.

6. Autoritetet gjyqësore të Palës kërkuese mund t'ia dërgojnë drejtpërsedrejti draftkërkesat dhe draftkomunikimet e parashikuara nga ky kapitull, autoriteteve gjyqësore të Palës së kërkuar përpara dërgimit zyrtar të një kërkesë apo komunikimi të tillë, me qëllim që të sigurohet efektivitet maksimal, me kusht që kërkesa të përmbajë informacionin e nevojshëm dhe dokumente shoqëruese që plotësojnë kërkesat e legjislacionit të Palës së kërkuar.

Neni 35

Forma e kërkesave dhe gjuhët

1. Të gjitha kërkesat e parashikuara nga ky kapitull bëhen me shkrim. Ato mund të transmetohen edhe me anë të mjeteve moderne të telekomunikimit, si komunikimi elektronik, me kusht që Pala kërkuese të jetë e përgatitur që nëse merr një kërkesë të tillë, të paraqesë në çdo kohë një dokumentacion me shkrim i këtij komunikimi si dhe origjinali. Megjithatë, çdo Palë, në çdo kohë, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë kushtet në të cilat është e gatshme të pranojë dhe ekzekutojë kërkesat e marra me anë të mjeteve të tjera të telekomunikimit, përfshirë komunikimin elektronik.

2. Objekt i dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, nuk do të kërkohet përkthimi i kërkesave ose shkresave që u bashkëlidhen atyre.

3. Çdo Palë, në kohën e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të rezervojë të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe shkresat që u bashkëlidhen atyre, të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e vet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në atë gjuhë që ajo do të caktojë. Çdo Palë mundet me këtë rast, të deklarojë se është e gatshme të pranojë përkthime në çdo gjuhë tjetër që mund të caktojë. Palët e tjera mund të zbatojnë parimin e reciprocitetit.

Neni 36

Legalizimi

Dokumentet e transmetuara në zbatim të këtij kreu nuk i nënshtrohen asnjë formaliteti të legalizimit.

Neni 37

Përmbajtja e kërkesës

1. Çdo kërkesë bashkëpunimi e parashikuar nga ky kapitull do të specifikojë:

- a) autoritetin që e ka bërë dhe autoritetin e ngarkuar për kryerjen e hetimeve ose procedimeve;
- b) objektin dhe motivin e kërkesës;
- c) çështjen, duke përfshirë aty faktet që lidhen më të (si data, vendi dhe rrethanat e veprës penale), me të cilat lidhen hetimet ose procedimet, përveçse në rastin kur kërkesa përmban një njoftim;
- d) në masën që bashkëpunimi sjell marrjen e masave shtrënguese:
- i) tekstin e dispozitave ligjore ose kur kjo nuk është e mundur, një deklaratë të ligjit përkatës të zbatueshëm; dhe
- ii) një tregues sipas të cilit masa e kërkuar ose çdo masë tjetër që ka efekte të ngjashme, mund të merret në territorin e Palës kërkuese në bazë të legjislacionit të vet;
- e) kur është e nevojshme dhe për aq sa është e mundur:
- i) detaje lidhur me personin/personat përkatës, duke përfshirë emrin, datën dhe vendlindjen, shtetësinë dhe vendndodhjen e tij/tyre dhe në rast se është person juridik, selinë e tij; dhe
- ii) pasuritë lidhur me të cilat kërkohet bashkëpunimi, vendndodhjen e tyre, lidhjet e tyre me personin/personat në fjalë, çdo lidhje me veprën penale, si dhe çdo informacion që disponohet lidhur me personat e tjerë, interesat për këto pasuri; dhe
- f) çdo procedurë e veçantë që dëshirohet nga Pala kërkuese.

2. Kur kërkesa për masë të përkohshme e paraqitur në bazë të seksionit 3, synon sekuestrimin e një pasurie që mund të jetë objekt i një vendimi për konfiskim që ka të bëjë me detyrimin për pagimin e një shume parash, kjo kërkesë do të tregojë shumën maksimale që kërkohet për t'u marrë për këtë pasuri.

3. Përveç treguesve të përmendur në paragrafin 1, çdo kërkesë e formuluar në zbatim të seksionit 4, do të përmbajë:

a) në rastin e nenit 23, paragrafi 1a:

i) kopje të vërtetuar në përputhje me vendimin e konfiskimit, dhënë nga gjykata e Palës kërkuese, dhe paraqitjen e motiveve që janë vënë në themel të vendimit, kur ato nuk përmenden në vetë vendimin;

ii) vërtetimin e autoritetit kompetent të Palës kërkuese, sipas të cilit vendimi për konfiskim është i ekzekutueshëm dhe nuk është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme;

iii) informacione lidhur me masën deri ku do të shkojë ekzekutimi; dhe

iv) informacione lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së masave të përkohshme;

b) në rastin e nenit 23 paragrafi 1.b, një paraqitje të fakteve të referuara nga Pala kërkuese, që të jetë e mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë vendim në bazë të së drejtës së brendshme të saj;

c) kur të tretët kanë pasur mundësi të kërkojnë të drejta, dokumentet që tregojnë se ata e kanë pasur këtë mundësi.

Neni 38

Kërkesat me të meta

1. Kur kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e këtij kreu ose kur informacionet e dhëna nuk janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë një vendim për kërkesën, kjo Palë mund t'i kërkojë Palës kërkuese të modifikojë kërkesën ose ta plotësojë atë me informacione të mëtejshme.

2. Pala e kërkuar mund të caktojë një afat për marrjen e këtyre modifikimeve ose informacioneve.

3. Në pritje të marrjes së modifikimeve ose informacioneve të kërkuara lidhur me një kërkesë të paraqitur në zbatim të seksionit 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar mund të urdhërojë të gjitha masat e parashikuara në seksionet 2 dhe 3 të këtij kreu.

Neni 39

Konkurrimi i kërkesave

1. Kur Pala e kërkuar merr më shumë se një kërkesë të paraqitur në bazë të seksioneve 3 dhe 4 të këtij kreu lidhur me të njëjtin person ose të njëjtat pasuri, këto kërkesa nuk e pengojnë Palën e kërkuar t'i trajtojë kërkesat që sjellin marrjen e masave të përkohshme.

2. Në rast konkurrimi kërkesash të paraqitura në bazë të seksionit 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar do të ketë parasysh konsultimet me Palën kërkuese.

Neni 40

Detyrimi për paraqitjen e arsyeve

Pala e kërkuar do të motivojë çdo vendim që refuzon, që shtyn ose që i vë kushte çdo bashkëpunimi të kërkuar në bazë të këtij kreu.

Neni 41

Informimi

1. Pala e kërkuar do të informojë pa vonesë Palën kërkuese:

a) për dhënien rrugë menjëherë kërkesës së formuluar në bazë të këtij kreu;

b) për rezultatin përfundimtar të dhënies rrugë të kërkesës;

c) për vendimin që refuzon, që shtyn ose i vë kushte, tërësisht ose pjesërisht, çdo bashkëpunimi të parashikuar nga ky kapitull;

d) për të gjitha rrethanat që bëjnë të pamundur ekzekutimin e masave të kërkuara ose që rrezikojnë ta vonojnë atë në mënyrë të konsiderueshme; dhe

e) në rast të masave të përkohshme të marra për një kërkesë të formuluar në zbatim të

seksionit 2 ose 3 të këtij kreu, për dispozitat e së drejtës së vet të brendshme që do të shkaktonin automatikisht heqjen e masës.

2. Pala kërkuese do të informojë pa vonesë Palën e kërkuar:

a) për çdo rishikim, vendim ose fakt tjetër që i heq tërësisht ose pjesërisht vendimit të konfiskimit karakterin e ekzekutueshëm të tij;

b) për çdo ndryshim, faktik dhe ligjor, që e bën të pajustifikuar këtë e tutje çdo veprim të ndërmarrë në bazë të këtij kreu.

3. Kur njëra Palë kërkon konfiskimin e pasurive në disa Palë mbi bazën e të njëjtit vendim konfiskimi, ajo informon për këtë të gjitha Palët përkatëse për ekzekutimin e vendimit.

Neni 42

Kufizimi i përdorimit

1. Pala e kërkuar mund t'ia nënshtrojë ekzekutimin e një kërkesë kushtit që informacionet ose elementet e provave të marra, pa miratimin e saj paraprak, të mos përdoren ose transmetohen nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllim hetimesh ose procedimesh, të ndryshme nga ato të specifikura në kërkesë.

2. Çdo Palë ose Komuniteti European, në kohën nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit të saj, mund të deklarojë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, se informacionet ose elementet e provave të dhëna prej saj në bazë të këtij kreu, pa miratimin e saj paraprak, nuk mund të përdoren nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllime hetimesh ose procedimesh, të ndryshme nga ato të specifikuara në kërkesë.

Neni 43

Konfidencialiteti

1. Pala kërkuese mund të kërkojë nga Pala e kërkuar që ajo të ruajë të fshehtë kërkesën dhe brendinë e saj, përveçse kur është e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës. Kur Pala e kërkuar nuk mund t'i përmbahet këtij kushti të konfidencialitetit, ajo do të informojë pa vonesë për këtë Palën kërkuese.

2. Pala kërkuese, kur për këtë i është bërë kërkesë dhe me kusht që kjo të mos bjerë ndesh me parimet themelore të së drejtës së vet të brendshme, do të ruajë konfidencialitetin e të gjitha provave dhe informacioneve të komunikuar nga Pala e kërkuar, përveç rasteve kur është e nevojshme për qëllime të hetimeve ose të procedimit të përshkruar në kërkesë.

3. Objekt i dispozitave të së drejtës së vet të brendshme, Pala që ka marrë një transmetim spontan informacionesh në bazë të nenit 20, do t'i përmbahet kushtit të konfidencialitetit të kërkuar nga Pala që transmeton informacionin. Nëse Pala tjetër nuk mund t'i përmbahet një kushti të tillë, ajo do të informojë pa vonesë për këtë Palën që transmeton informacionin.

Neni 44

Shpenzimet

Shpenzimet e zakonshme të bëra për ekzekutimin e një kërkesë janë në ngarkim të Palës së kërkuar. Kur del e nevojshme, kryerja e shpenzimeve të mëdha ose të jashtëzakonshme për t'i dhënë rrugë kërkesës, Palët merren vesh për kushtet në të cilat do të ekzekutohet si dhe për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve që lidhen me këtë kërkesë.

Neni 45

Dëmet

1. Kur një person ka ngritur padi mbi përgjegjësinë për dëmet që rezultojnë nga kryerja ose

moskryerja e një akti në kuadër të bashkëpunimit të parashikuar nga ky kapitull, Palët përkatëse do të konsultohen midis tyre dhe kur është rasti, do të përcaktojnë mënyrën e dëmshpërblimit dhe shlyerjes së duhur.

2. Pala që është objekt i një kërkesë për dëmshpërblim, do të përpiqet të informojë pa vonesë për këtë Palën tjetër, kur kjo mund të ketë interes në atë çështje.

KREU V BASHKËPUNIMI NDËRMJET FIU-VE

Neni 46 **Bashkëpunimi ndërmjet FIU-ve**

1. Palët do të garantojnë që FIU-të, sipas përcaktimit në këtë Konventë, të bashkëpunojnë për qëllimin e luftës kundër pastrimit të parave, të mbledhin dhe analizojnë ose, sipas rastit, të hetojnë brenda informacionit përkatës të FIU-t, në lidhje me çdo fakt që mund të jetë tregues për pastrimin e parave, në përputhje me kompetencat e tyre të brendshme.

2. Për qëllime të paragrafit 1, çdo Palë do të garantojë që FIU-të të shkëmbejnë, spontanisht ose sipas kërkesës, në përputhje me këtë Konventë ose në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit ekzistues ose të ardhshëm, në përputhje me këtë Konventë, çdo informacion të mundshëm që mund të jetë i rëndësishëm për përpunimin ose analizimin e informacionit ose sipas rastit, për hetimin nga FIU në lidhje me transaksionet financiare që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe personat fizikë dhe juridikë të përfshirë.

3. Çdo Palë do të garantojë që ushtrimi i funksioneve të FIU-t në bazë të këtij neni, të mos ndikohet nga statusi i tyre i brendshëm, pavarësisht nëse janë autoritete administrative, përmbartuese apo gjyqësore.

4. Çdo kërkesë e bërë në bazë të këtij neni do të shoqërohet me një përshkrim të shkurtër të fakteve të njohura për FIU-n kërkuar. FIU do të specifikojë në kërkesë se si do të përdoret informacioni i kërkuar.

5. Nëse një kërkesë është bërë në përputhje me këtë nen, FIU i kërkuar do të japë të gjithë informacionin përkatës, duke përfshirë informacionin financiar të mundshëm dhe të dhënat e kërkuara për ekzekutimin ligjor, që janë kërkuar në kërkesë, pa qenë nevoja për një letërporosi formale, në bazë të konventave ose marrëveshjeve të zbatueshme ndërmjet Palëve.

6. Një FIU mund të refuzojë nxjerrjen e informacionit që mund të çonte në cenimin e një procedimi penal të nisur në Palën e kërkuar ose në rrethana të jashtëzakonshme, nëse do të nxirrej informacioni kjo nuk do të ishte në raport me interesat e ligjshme të një personi fizik ose juridik ose të Palës përkatëse, apo nuk do të ishte në përputhje me parimet themelore të ligjit vendas të Palës së kërkuar. Çdo refuzim i tillë shpjegohet përkatësisht për FIU-n që kërkon informacionin.

7. Informacioni ose dokumentet e marra në bazë të këtij neni, do të përdoren vetëm për qëllimet e parashikuara në paragrafin 1. Informacioni i dhënë nga një FIU homolog nuk i jepet një pale të tretë dhe as nuk përdoret nga FIU marrës për qëllime të ndryshme nga analiza, pa pëlqimin paraprak të FIU-t dhënës.

8. Gjatë transmetimit të informacionit ose dokumenteve në përputhje me këtë nen, FIU transmetues mund të caktojë kufizime dhe kushte për përdorimin e informacionit për qëllime të ndryshme nga ato të caktuara në paragrafin 7. FIU marrës përmbush çdo kufizim dhe kusht të tillë.

9. Nëse një Palë dëshiron të përdorë informacionin ose dokumentet e transmetuara për hetime ose procedime penale për qëllimet e parashikuara në paragrafin 7, FIU transmetues nuk mund të refuzojë pëlqimin e tij për një përdorim të tillë, përveçse kur e bën këtë në bazë të kufizimeve sipas ligjit të tij të brendshëm ose të kushteve të parashikuara në paragrafin 6. Çdo refuzim për dhënien e një pëlqimi të tillë do të shpjegohet në mënyrën e duhur.

10. FIU-të do të marrin të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë masat e sigurisë, për të

garantuar që informacioni i dhënë në bazë të këtij neni, të mos i jepet asnjë autoriteti, agjencie apo departamenti tjetër.

11. Informacioni i dhënë do të mbrohet në përputhje me Konventën e Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale (ETS nr.108) dhe duke marrë parasysh Rekomandimin NrR(87)15 të 15 shtatorit 1987 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në lidhje me përdorimin e të dhënave personale në sektorin policor, nga të paktën të njëjtat rregulla të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si ato që zbatohen në bazë të legjislacionit të brendshëm dhe që janë të zbatueshme për FIU-n kërkuar.

12. FIU transmetues mund të bëjë kërkesa të arsyeshme në lidhje me përdorimin ndaj informacionit të dhënë dhe FIU marrës, sipas rastit, jep të dhënat përkatëse.

13. Palët do të tregojnë njësinë që është një FIU në kuptim të këtij neni.

Neni 47

Bashkëpunimi ndërkombëtar për shtyrjen e transaksioneve të dyshimta

1. Çdo Palë do të miratojë ato masa legislative dhe të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme, për të lejuar veprime të menjëhershme për t'u filluar nga FIU, me kërkesën e një FIU të huaj, për të pezulluar ose mos dhënë pëlqimin për një transaksion që po kryhet për këto fitime dhe në varësi të të njëjta kushteve që zbatohen në ligjin e tij të brendshëm, në lidhje me shtyrjen e transaksioneve.

2. Veprimi i përmendur në paragrafin 1 do të ndërmerret nëse FIU i kërkuar është i bindur, me arsyetimin e FIU-t kërkuar, që:

- a) transaksioni ka të bëjë me pastrim parash; dhe
- b) transaksioni do të ishte pezulluar ose pëlqimi për transaksionin që po kryhet nuk do të ishte dhënë, nëse transaksioni do të ishte objekt i një raporti të brendshëm si transaksion i dyshimtë.

KREU VI

MEKANIZMI MONITORUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 48

Mekanizmi monitorues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Konferenca e Palëve (COP) është përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të Konventës. COP:

- a) monitoron zbatimin si duhet të Konventës nga Palët;
- b) me kërkesën e një Pale, shpreh një mendim për çdo çështje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës.

2. COP kryen funksionet në bazë të paragrafit 1.a të mësipërm, duke përdorur çdo përmbledhje publike të bërë nga Komisioni i Zgjedhur i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave (Moneyval) (për vendet e Moneyval-it) dhe çdo përmbledhje publike të dhënë nga FATF (për vendet e FATF-it), duke shtuar sipas rastit edhe pyetësorët periodikë vetëvlerësues. Procedura monitoruese trajton fushat që mbulohen nga kjo Konventë vetëm në lidhje me ato fusha që nuk mbulohen nga standardet e tjera përkatëse ndërkombëtare për të cilat vlerësimet reciproke kryhen nga FATF dhe Moneyval.

3. Nëse COP është i mendimit se atij i duhen të dhëna të tjera për të kryer funksionet e tij, ai hyn në kontakt me Palët përkatëse, duke përdorur, nëse kjo kërkohej nga COP-i, procedurën dhe mekanizmin e Moneyval-it. Pala përkatëse i raporton COP-it. Mbi këtë bazë, COP-i vendos të kryejë apo jo një vlerësim më të avancuar të pozicionit të Palës përkatëse. Kjo mund të përfshijë, por jo domosdoshmërisht, një vizitë në vend nga një ekip vlerësimi.

4. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës, ato përpiqen ta zgjidhin mosmarrëveshjen me anë të bisedimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër paqësore sipas zgjedhjes së tyre, duke përfshirë referimin e mosmarrëveshjes COP-it, një gjykatë arbitrazhi, vendimet e së cilës janë detyruese për Palët, ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas rënies dakord nga Palët përkatëse.

5. COP-i miraton rregullat e veta procedurale.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës mbledh COP-in jo më vonë se një vit pas

hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj, mbledhjet e rregullta të COP-it mbahen në përputhje me rregullat procedurale të miratuara nga COP-i.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe për Shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Këto shtete mund të shprehin pëlqimin e tyre për të respektuar:

- a) nënshkrimin pa rezervë për sa i përket ratifikimit, pranimi ose miratimit; ose
- b) nënshkrimin, objekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit, që pasohet me ratifikimin, pranimin ose miratimin.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës kur gjashtë shtete nënshkruese, nga të cilat të paktën katër janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.

4. Për çdo shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për të respektuar këtë Konventë, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës së shprehjes të pëlqimit për të respektuar Konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.

5. Asnjë Shtet Palë në Konventën e vitit 1990 nuk mund ta ratifikojë, pranojë apo miratojë këtë Konventë, pa respektuar të paktën dispozitat korresponduese të Konventës së vitit 1990, zbatimin e së cilës e ka detyrim ligjor.

6. Që prej momentit të hyrjes së saj në fuqi, Shtetet Palë në këtë Konventë, që janë njëkohësisht edhe Shtete Palë në Konventën e vitit 1990:

- a) do të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente në marrëdhëniet mes tyre;
- b) do të vazhdojnë të zbatojnë dispozitat e Konventës së vitit 1990 në marrëdhëniet me Shtetet Palë në Konventën e vitit 1990, por jo në këtë Konventë.

Neni 50

Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit me Shtetet Palë të Konventës, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve Palë që gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit.

2. Për çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 51

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, mund të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çdo datë tjetër të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të

Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 52

Marrëdhënia me konventat dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare shumëpalëshe lidhur me çështje të veçanta.

2. Palët në Konventë mund të lidhin midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, me qëllim plotësimin ose përforsimin e dispozitave të saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Kur dy ose disa Shtete Palë kanë lidhur tashmë një marrëveshje ose një traktat për një objekt që mbulohet nga kjo Konventë ose kur kanë vendosur sipas një mënyre tjetër marrëdhëniet e tyre lidhur me këtë subjekt, ato do të kenë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje, traktat, në vend të kësaj Konvente, nëse lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar.

4. Shtetet Palë të cilat janë vende anëtare të Bashkimit European, do të zbatojnë në marrëdhënie ndërmjet tyre rregullat përkatëse të Bashkimit dhe Komunitetit European në atë shkallë që këto rregulla rregullojnë dhe janë të zbatueshme për çështjen në fjalë, pa cenuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente, si dhe pa cenuar zbatimin e plotë të saj në marrëdhënie me Palët e tjera.

Neni 53

Deklaratat dhe rezervat

1. Çdo shtet ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të bëjë një ose më shumë deklarata që figurojnë në nenin 3 paragrafi 2, nenin 9 paragrafi 4, nenin 17 paragrafi 5, nenin 24 paragrafi 3, nenin 31 paragrafi 2, nenin 35 paragrafët 1 dhe 3, dhe nenin 42 paragrafi 2. Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet.

2. Çdo shtet ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mundet gjithashtu të deklarojë se i lejon vetes plotësisht ose pjesërisht, rezervën/at e parashikuara në nenin 7 paragrafi 2 nënparagrafi c, nenin 9 paragrafi 6, nenin 46 paragrafi 5 dhe nenin 47.

3. Çdo shtet ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë mënyrën me anë të së cilës synon zbatimin e nenit 17 dhe 19 të kësaj Konvente, veçanërisht duke marrë në konsideratë marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale. Për çdo ndryshim në këtë informacion, do të njoftojë me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

4. Çdo shtet ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit miratimit ose aderimit, mund të deklarojë:

- a) se nuk do të zbatojë nenin 3 paragrafi 4 të Konventës; ose
- b) se nuk do të zbatojë nenin 3 paragrafi 4 të Konventës vetëm pjesërisht; ose
- c) mënyrën që mendon zbatimin e nenit 3 paragrafi 4 të Konventës.

5. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë tjetër.

6. Çdo shtet që ka formuluar një rezervë në bazë të këtij neni, mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht, duke i drejtuar një njoftim me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

7. Pala që ka formuluar një rezervë lidhur me një dispozitë të kësaj Konvente, nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një Palë tjetër; ajo mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite në atë masë që ajo e vetë e ka pranuar atë.

Neni 54 **Amendamentet**

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente ndaj kësaj Konvente dhe çdo propozim do t'i komunikohet shteteve anëtare të Këshillit dhe çdo shteti joanëtar që ka aderuar ose është ftuar të aderohet në këtë Konventë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, në përputhje me dispozitat e nenit 50.

2. Çdo amendament i propozuar nga një Palë, i komunikohet Komitetit European për Problemet Penale (CDPC), i cili i paraqet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti European për Problemet Penale (CDPC), dhe mund të miratojë amendamentin me shumicën e përcaktuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës.

4. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do t'i transmetohet Palëve për pranim.

5. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë, pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se e kanë pranuar atë.

6. Me qëllim të përditësimit të listës së veprave penale në shtojcën bashkëlidhur, mund të propozohen amendamente nga secila Palë ose nga Komiteti i Ministrave. Këto propozime për amendime do t'i komunikohen Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

7. Pas konsultimit me Palët joanëtare, Komiteti i Ministrave mund të miratojë një amendim të propozuar në përputhje me paragrafin 6 nga shumica që parashikohet në nenin 20 pika "d" të Statutit të Këshillit të Europës. Amendamenti do të hyjë në fuqi në vijim të përfundimit të periudhës prej 1 viti, nga data që i është dërguar Palëve. Gjatë kësaj periudhe, çdo Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për kundërshtime të mundshme për hyrjen në fuqi të atij amendamenti, për sa i përket asaj Pale.

8. Nëse një e treta e Palëve njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për një kundërshtim për hyrjen në fuqi të amendamentit, amendamenti nuk do të hyjë në fuqi.

9. Nëse më pak se një e treta e Palëve njoftojnë në lidhje me një kundërshtim, amendamenti do të hyjë në fuqi për ato Palë, të cilat nuk kanë bërë njoftim për kundërshtimin.

10. Kur amendamenti ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafët 6 deri 9 dhe një Palë ka shprehur kundërshtim për atë amendament, atëherë ky amendament do të hyjë në fuqi për sa i përket Palës në fjalë, e cila nuk e ka pranuar atë, në ditën e parë të muajit në vijim të datës në të cilën ajo Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për pranimin e tij. Një Palë që ka bërë një kundërshtim, mund ta tërheqë atë në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

11. Nëse Komiteti i Ministrave ka miratuar një amendim të propozuar, një Shtet Palë apo Komuniteti European nuk mund ta respektojë këtë Konventë, pa pranuar në të njëjtën kohë amendamentet e bëra.

Neni 55 **Denoncimi**

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Megjithatë kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e konfiskimit të kërkuar në bazë të nenit 23, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente në një datë përpara hyrjes në fuqi të denoncimit.

Neni 56 **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e neneve 49 dhe 50 të saj;
- d) çdo deklaratë ose rezervë në bazë të nenit 53;
- e) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Varshavë, më 16 maj 2005, në një origjinal të vetëm në gjuhët frënge dhe angleze, të dyja tekstet njëlloj të besueshme, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar secilit prej shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit Europian, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, si dhe çdo shteti tjetër të ftuar për të aderuar në të.

SHTOJÇË

- a) Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal dhe shantazhi
- b) Terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit
- c) Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e emigrimit
- d) Shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve
- e) Trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope
- f) Trafikimi i paligjshëm i armëve
- g) Trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera
- h) Korrupsioni dhe mitmarrja
- i) Mashtrimi
- j) Falsifikimi i monedhës
- k) Falsifikimi dhe pirateria e produkteve
- l) Krimi mjedisor
- m) Vrasja, plagosja e rëndë trupore
- n) Rrëmbimi, kufizimi dhe pengmarrja e paligjshme
- o) Vjedhja ose plaçkitja
- p) Kontrabanda
- q) Zhvatja
- r) Falsifikimi
- s) Pirateria dhe
- t) Manipulimi i shitblerjes së letrave me vlerë dhe i tregut.